Begzat RRAHMANI

COPËTIM NATE

B E G Z A T R R A H M A N I

C O P Ë T I M N A T E

Poezi

Feniks – Kërçovë, 2004

Biblioteka : MJELLMA

Redaktor : Rami Kamberi

Recenzentë : Numan Limani
Ilir Ajdini

Lektor : Dr. Nashyt Sadiku

Ballina : Rijad Bajrami

GRISJA E NATËS

Drita Hënë
griste
terrin e natës
këtë e vërejta
nëpër xhamin e vdekjes
Astma gërrynte
mushkëritë pa forcë
shqetsoheshin rrezet!

I. VDEKJEN E KEMI HËNGËR

PIEDESTAL I KALBUR

Simfoni varresh
në tokën time
ofkëllimë
vitesh makabër
për zhdukje gjurmësh
prijësit e sëmur
piedestali i kalbur.

SHPIRTI PA FJALË

Nëpër kreshtat
e një vendi të huaj
me shekuj ruhet
vendlindja në zemër
një ditë të kthehet
gjaku në damarë
të mundi akullin
e lules pranverore
-SHPIRTI I FJALËS-
i tokës - FENIKS
në lëkurën e stinës sime.

MERIMANGA

Thurë rrjetën
kafshon pafajsinë
kënaqet si lavire me të pasurin
pa turp drejton gishtin
kah ecin shqiptarët
drejt zjarrit që vet e kallë
për lotë nënash
syri ngjyrë gri i kohës moderrne !

BULËZIMI

Në breg të diellit
formula natyre
aromë e trurit
me eshtra lulebozhuri
korridoret e nënës tokë
copëra mushkërishë
plotë silikozë
eshtra të karbonizuara
bulëzojnë nga djersa.

HISTORI E GRISUR

Pikat e KUMUSIT
më dhanë shpirt të kaloj
stepën e pa fund të jetës
i ngujuar në mes të bishave
që rastësisht kanë humbur:
dy këmbë, brirë e bishta
nëpër ferrat e shekujve
për të marrë tjetër emër
e me qëllim humbën dashurinë
për të hapur plagë të thella
që i ruajnë në shpirtin
-HISTORI E GRISUR-

RROBET E VDEKJES

Ne kemi vendosur pritë
për vrasje dhe djegëjen e farës
nga frengjitë amanet.
Bota është e verbët
ne e duam tokën tonë
ju alarmoni për vrasje kopilash
ne s'paskeshim të drejtë për pjellën tonë
ne s'e blejmë qiellin
por mbjellim gjak në tokë
ecim me rrobet e vdekjes për lindje të re
ne shkojmë rrotull :
-vatan, lindje, dashuri dhe vdekje për vatan
pritat në frengji janë vdekje për armikun.

PRISHJA E KUPTIMIT TË ËNDËRRËS

Mendonit se jemi çerdhe zogjësh
Pa krahë dhe lakuriq
Në lisin e vjetër plotë kujtime
Kohërash dhe plagësh nga vizitorët
E pa ftuar të shkretëtirave
Që prishnin qetësinë dhe kuptimin e ëndërrës
Në mëngjezin e qetë plotë këngë
Dhe aromë lulesh pranverore
Duke zhdukur lumturinë e atyre në djep !
Mendonit se jemi ata dhënës të besës
Dhe s'dimë kur na tradhtoni-
Shihni se shkretëtira u ka shkretëruar
E malet u kanë egërsuar tepër
Zbutni pak zemrat dhe kapeni një rreze
Të kuptoni jetën dhe qenjen njeri !

PUSHKATIMI IM

Nga lartësitë e qiellit
pëllumbat më sjellin
mendime të moçme
për libër të ri.
Meteori bëhet copë e grimë
toka nxjerrë fjalë të bukura
bashkë me këngën e vjetër
për gjak lirie
të pushkatimit tim
bota me sy dëshmon !

TRURI I KULLUAR

Trupi i djegur
hiri miell për gatim
në zemrat e fatosave
për fjalën Atëdhe
plot aromë e ngjyra
shpirtërat e poetëve
me trur të kulluar
nëpër gurë lumenjsh
vargjet qirinj jete
zëri jehon si flamuri në valim.

VDEKJEN E KEMI HËNGËR

Kemi dhënë betimin
s’ luajmë asnjë pëllëmbë
korridoret mbani për ju!
pas betimit-
vdekjen e hëngrëm
na ka ngelur tuli i jetës
që thonë se s’ mbarohet kurrë
ndoshta për këtë vend
ne do të vdesim,e ju do të cofni
ne s’ dimë të egërsohemi
amanet kemi durimin e mirësinë
por edhe gjuajtjen në lule të ballit
kurrë s’ kemi pasur punë:
me gra,plaka,pleq dhe fëmijë
prandaj kemi trima betejash
që krenohemi ne dhe bota
jo si ju kapedana barbarë…

SHQIPONJA E NGUJUAR

- B. RR -

Atje gjeta ndërtime të moçme
shqiponja ishte gravuar në gur
toka zvogëlohej si bebëz syri
uniteti i plotë në morte
te varri vetëm me tri lule
qante fëmija për vobegësinë e varrit
sumbullat kundërmonin aromë dashurie
dikush tha:flitet me pietet
la të mitura pa pasuri
njerëzit largoheshin
aroma zgjeronte parzmën
shqiponja lotonte për ngujim
dhe unitetin mortor
putha çupën me dhembje dashurie…

SHTIMI I QYQES

Më kanosej një bishë
me dy këmbët e ngelura
zgërdhihej e lëvdohej
me diçka varë në qafë
tregonte djepin që s’ ekziston
duke shkërmit tokën plotë xehe
për mendime të fëlliqta
Zoti i dha sterilitetin
dhe shtim qyqeje
në trup s’ ka gjak njeriu…

KRATERI I LIRISË

Shenjtëri është lufta për liri
e për këtë tokë pak është luftuar
ajo s' është lagur as me lotë
e as me gjak,por vetëm me dhembje
ata që kanë pasur dhembje kanë qenë të huaj
sepse nënës kur i thonin nënë turpëroheshin
-ASHTU S' FITOHET LIRIA-
Sfinksat i shikonin vetëm më një anë
duke turbulluar trurin dhe dritën e syrit
duke thyer jetën në pasqyrën e torturuar
nga mendimet që i ruante sfinksi pas malit
për shkatërrimin e urave të kësaj toke
dhe premjet e damarëve që rrjedh një gjak
si llava nëpër plasaritjet e tokës
gjer te krateri i vullkanit që i thonë liri
e atyre që pengojnë lirinë duhet t' ua vrasish
udhën…

VARRI POETIT

Vullkani i pa shuar
    -varri i poetit-
mendimet shpërthejnë
si llava e tokës
me kundërmim dijenie
flaka dhe zhurma
      -bibliotekë-
e kohës moderrne.

MJEGULLAT SHEKULLORE

Luftë me mjegullat
për një rreze shprese
me gjysmë mushkëri
Huti mbi çati ndjellte kob
bushtra uluronte në oborr
si nënë për djalin e hastretit
që e djegin në turrën e druve
për rebelizim
të mjegullës shekullore
dhe kryqit plotë hile…

ROJA E QIELLIT

Drita e yllit në qiell
është rruga ime
xhunglat me pabesi
i kam rrugë jeta
gjurmët trimëri
gjaku lirshëm nëpër damarë
me zërin e këngës
plot filiza lashtësie
bënë roje në tokë e qiell
gabimet i paguajtëm me gjak!

JETA NË GOTË UJI

Rrugë e gjatë
me ujë ndër sjetull
diku preva një dru
për lundën e ëndërrave
drejt rrezes së zbehtë
dhe këngës së zogjëve në kor
në skaj të botës
forcë më jepte uji në gotë
Jeta…

PISLLËK TRURI

Në fushën e luftës
edhe amat shterin
si gjakaku i gjakpirësit
në trupin pa pikë shpirti
që vetvetes ia kall rrënjët
dhe drita shuhet në gjithësi
nga ajri i gjakosur në vitn e keq
TAVOLINA E VDEKJES KA PËRPARËSI
diellin e detyrojnë të harrojë
për lindjen se ashtu dëshiron
shëmtia e botës së krimbposur
nga kasapi bir lavireje
I KRIJUAR NGA PISLLËK TRURI.

DHEMBJE TË THELLA

Mendimet e xhunglës së pashkelur
erërat e egra ndalin aromën e lules
që shtang frymëmarren jetësore
nëpër xhungël që vetëm rrezet e diellit
shohin duke rrotulluar hijen
e tropikalëve plot myshqe e laso
që kurrë nuk zbulohet fshehtësia e tyre
nëpër mendimet e shpendit të lënduar
që rrugën e drejtë e sheh me një sy
por atje në skaj ndodhet ujku gojë hapur
duke menduar për ujin që kurrë s' ia ka turbulluar
por ujkun në xhungël e mundon butësia
pasi e keqja vetëm me të keqe mundet
DREJTËSINË E VRET HISTORIA E RE
me buzëqeshje të ëmbëla laviresh
e me dhembje të thella në jetë…

USHTARËT E GURËZUAR

Vriten pëllumbat
gjaku vërshon
ushtarët gurëzohen
zemrat shndërrohen në histori
Feniksat lindin në sinor të vet
projektilat zhduken pa gjurmë
arkeologët grinden
për gjeografinë e pëllumbave.

DALLGËZIM MENDIMESH

Nën rrezet e purpurta të hënës
mjegullat shkrihen në pluhur vizullues
trupi qetësohej me ëmbëlsi jete
luhatjet e degëve afronin agimin
bashkë me cicërimën dhe aromën e luleve
qielli merr ngjyrë të gjelbërtë
kurmi i natës shkrihej si akull
në fluturim gostitej pulbardha
valët bënin piktura të çuditshme
në oazë mendime të dallgëzuar
kalimtarët sofër e bisedave boshe…

SHPIRTI GJAK GJARPËRI

Truri i vullkanit
depërton në natë e shkyer
toka dridhej purtekë
përmbysen ëndërrat çnjerëzore
zemrat e hapura për mëkate
gëzojnë trurin e mykur
bota rrënohej nga shpirti
me gjak gjarpëri,mbështjellë
acari përmbys vullkanin
të ngujuar në shtëpi letre
qetësi të imagjinuar ajri
me helmin nga duhma-njeri…

II . COPËTIMI I NATËS
==========

KARBONIZIMI I LULES

Zëri i kokës së groposur
depërton nëpër mermerin e zi
për shpirtin që digjet flakë
në yllin që se njeh astronomia
duke e karbonizuar aromën e lules
në dhembjet e trupit pa shpirt
pasi rrënjët i kalben egërsisht
nëpër shtëpi të mbyllura
bashkë me ikonat e rrejshme
në yllin kryq pa gjithësi.

KËNGË ZJARRI

Gjelat këndojnë
vdekja vallëzon
nëpër oborre
dita bëhet pluhur dielli
kafkat rëndojnë skeletet
vitet e shkrira në jetë
mbi supe bukë mendimesh
bota sillet rrotull
me plagë dëshirash
përplasen udhëkryqeve
duke lidhur ura shekujsh
me këngë zjarresh
në shtëpi të huaj monstrumët!

TRURI I FËMIJËVE TË KËRRUSUR

Nga plagët tona dielli merr zjarr
Truri i fëmijëve piqet më herët
Ata kërrusen pa hetuar
Goja hapet prej peshës
Fjalë të hidhura s' gëlltiten
Sytë bëjnë roje
Gjumin e vdekur
Se duan trashigim
As lëvdatat plumba pas shpine.

TË VËRTETA TË PA QENA

Dera hapet në kullën e vjetër
me sofrën plot muhabet dhe histori
shpirtërat e shqetsuar për tokë
dhe diell që ngroh
me aromën dhe cicërima
duke zhduk tërbime të moçme
ata flasin të vërteta të pa qena
për karrierë lumi të vërshuar.

IDE TË PURPURTA

Valët rrokullisen nga mendime kokash
që njerëzit i përplasin për muri pa mëshirë
trutë bashkohen me gjakun në ide të purpurta
shpirtrat ikin larg në qiell nga hidhërimet
mishrat futen thellë në tokë për një shenjë varri
për ushqim të servuar për urtakët e tokës
historianët të flasin e poetët të thurin vargje
për marritë e kanibalëve mbi tokë!

COPËTIM NATE

Nata zhduket me rrezet e hënës
nëpër valët e detit të tërbuar
e atje larg diku në skaj
përplasen nëpër shkëmbinjt e thepisur
e ajo natë bëhet copë e thërrmija
atëhere rrezet e hënës duke u valvitur
nëpër detin pafund përqeshin natën
që bëhet një shkumë e fëlliqur deti.

ROB I GJUMIT

Gjumi thellon
si brendia e detit
në ëndërr të bukur
robin e gjumit
trupat kënaqen
pa hetuar gërvishjet
e natës me thonjë mace
pastaj me cinizëm
ngushëllojnë
për kokë të shëndoshë.

MERIMANGA NË PARIS

-Omer Kaleshit -

Harqet e Urës së Gurit
ia dërmonin trurin
si elektromotorri në punë
e ai zhurmën e kthente
në spektër ngjyrasha
si lulet e bukura të
-CHAMPS ELIZES-
ku ateleja e pritte
Artistin Kapuç Bardhë
në atarin e Vejushës së Zezë
ku nënën se kalb Toka e Hënës
duke ju lutur Zotit të Senës
për birin e urtë duke mallkuar
Merimangën e Zezë për shpifjet
e shekullit njëzet dhe pluhurin
që i hudhet botës së prishur
ARTISTI QESH E QANË SHQIPTARÇE…

GJENI

Gjeni i pastër
kurrë si ngjitet
Buçës e Qenit
që kënaqin epshet
e mëkatojnë shpirtin.

RRËNJËT E ZISË

Vrasësit e sojit të vet
përlyejnë rrezet e diellit
duke i këputur aty-
ku Zoti jep gjasllëri.
deti turbullohet në mëngjes
nga lotët e përgjakur të
shkëminjëve për rreth.
mushkëritë e kalbura
mallkojnë katilin
duke ia prerë damarët
që vinë nga rrënjët e zisë.

VDEKJA HIDHËROHET

Aty ku shkrihet truri
ka bisedë burrash
veshët bëhen të lumtur
zemra qetëson epshet
shpirtit i zgjatet jeta
dhe mbushet plot vepra
vdekja hidhërohet
sepse bëhet plakë.

DITA E TMERRIT

Tinzisht më vritnin lotët
që rrokulliseshin si shkëmbinj
nëpër faqet e zverdhura
të zemrës së tronditur
ku eteri thirrte
njeriun e maskuar
e ai hamendej mbi viktimën
dhe betimin e Hipokratit
një zë ulurimë i vinte
duke depërtuar thellë në zemër
ato dy sumbulla u rrokullisën
faqeve të viktimës pa shpirt
duke thënë :”Ditë Tmerri”
rrudha e thinja u shtuan…

RREZE PLUMBASH

Së bashku me terrin
fundoseshin në shishen
e zbrasur atë natë
duke shikuar siluetën
e saj nudo përpara pasqyrës
të copëtuar si yjet që derdheshin
në qiellin e pa fund,shpirtin
ma copëtonin ato rreze plumbash
nga thimthat e çuara përpjetë
dhe gjumin e ikur atë natë
nëpër rrezet e hënës dhe
shpirtin e derdhur nëpër
atë shishe që zbrazej
atë natë të mallkuar…

FATI…

Dikund nëpër valët
e detit të turbulluar
thonë ndodhet fati im.
Për atje rrugë s’ ka
por rrallë nëpër terr
vizullon një rreze drite
nga lart vjen e fundoset
si meteor në detin pa fund.
Mua valët më përplasin
nëpër shkëmbinjtë e shkyer
e një zë përsëritet pa ndal:
- VAZHDO…

DAMAR JETE

- J . G –

E fortë ishte qafa
për peshën e trupit
por pesha e trupit
tmerronte armikun.
Për rehatinë e vet
ai zgjodhi plumbat
për qetsimin e poetit
ajo rrëke gjaku
u bë damar jete.

AUREOLA E LAVDISË

-Safet Belulit -

Burgu pret të dënuarin
nga i dënuari për të dënuar
pinjollin e trungut sa vet toka
nga trungu i vetmuar dhe parrënjë
me re breshëre e bubullima rrufeshë
toka se duron at trung qelbësirë
e përmbys edhe burgun me terrin e madh
lindin lastarë bashkë me aurorën e mëngjesit
për tu dalë Zot-
si shqiponjat krahëhapur në lartësi…

17 . korrik .2003
Zhubrinë

SHI PIKËLLIMI

Mjekrra u rrit
flokët u zbardhën
dhëmbët ranë
buka iku nga sofra
lugët u bënë plumba
motin e kapi
-SHI PIKËLLIMI-
palaçot llomotitnin
për varrin e vjetër
të lules eliksir
që ktheu shqiponjën
në kupën qiellore.

KINI KUJDES

Korbat në besë
deshën t' ia thyejnë
krahët shqiponjës
kurrë të mos fluturojë
në trollin e vet.
Zgjodhën kohë të pa kohë
dhimbja të jetë më e madhe
e bota mos ta hetojë fare.
Shqiponja fluturon
bota hapi sytë e lexoi
mallkimin e Zotit:
"Siç jeni të pa besë,
ashtu keni edhe ngjyrën"
-JU SHQIPONJA KINI KUJDES-.

FORTËSIA

Nata rëndon
sa fundi i detit
mbi shtratin tim
plaga varr i hapur
nga torturat çnjerzore
dhe lotët gjak qyqesh.
Trupin e tharë
por me zemër fortësi guri
dhe shpresë meteori.

QENTË E BALLKANIT

Rruga gjarpëruese
plot ferra e molla ujku
gurët dhe kryqet të rrëzuar
nëpër tokën e groposur
shëmton varrezat e Çukës
ku me shekuj bënë roje
rrapi plak ,por krenar.
Historinë e shkruar
ua lexon çangu tingëllues
nëpër afreskat e Onufrit
ku qentë e Ballkanit
e ndiqnin për zhdukje.
Ai qetë nën hijen e Rrapit
vulosi vjetërsinë e vet.

III. DALJE NGA FERRI

RINGJALLJA

Këto vargje do t’i ringjalli
nipi i stërnipit tim
me pak lule te varri
dhe dy fjalë krenarie
pastaj njeriu me nam
me shumë fjalë do të stolisi
trurin e harruar nën pluhur
eshtrat do të mbëlidhen
për të vazhduar rrugën…

MOLLA PROVOKUESE

Rrënjët kërkonin ushqim
Për shtatin dhe frutat
Kurse dielli kërkonte ylberin
Për të zgjedhur ngjyrën e
-MOLLËS PROVOKUESE-
Hëna me kujdes vështronte
Ndryshimet dhe zbukurimet
E trupave të xhveshur
Nën qiellin plot rreze yjesh
Që prej kohësh zgjonin epshet
Për ardhjen e lumturisër prindore.

DALJE NGA FERRI

-Fishtës-

Shkelmimi i viteve
shndërrohej në pluhur
për oborrtarrët e mjerë
duke mos ofshuar shpirtin
për meshën e popullit…
që mbillej si këngë bilbili
në shpirtin e meshtarëve
duke ua hequr dhimbjet
e ua shtuar jetën…
kurse oborrtarët çmendeshin
pse hapej dera e ferrit.

KU-KU-JA

Shkulni atë dru
ku qyqja lëshon vezë
-KU-KU-JA- e saj
s’ është cicërimë
por mallkim jete
për nënën klloçkë
ajo ia vret fëmijët
për të rritë ato
që kurrë s’ kanë pasur
s’ kanë e s’ do të kenë
-VATAN-.

ËNDËRRA STERILE

Copëra ëndërrash
shpaloj në mëngjes
pastaj i varros
si nusja qimet
mbi syrin belicë
në pasqyrë shikoj
-MARIFETLLËQET-
e magjistares plakë
për shkatërrimin tim
për rehatin e vet
në trollin e huaj.

FIKS – VAKSINA

S’mund të jem i lumtur
në këtë gjimnaz pa emën
AVALLA çdo ditë mundohet
të ma shkrijë trurin.
fëmijët e pasun
pinë cigare “XHOJINT’
-DISPONIMI-
ca kanë edhe “QILLAMA”.
në bodrumin e argëtimit
FIKS VAKSINA.
përfitim me ofendime
jeta bahet çdo ditë
ma e zezë se terri.
zani i shpëtimit më vjen
nga JUGU në gjuhën time.

1965-AVALLË
Beograd

HËNA

Ditën i lutet diellit
për punën që duhet
të bëjë natën.

Dielli se dëgjon fare
ajo afrohet me kujdes
e puth në të dy faqet
atëherë dielli largohet
Hënës i shkëlqen fytyra.

SILUETA

Vetes ia ngula thikën
si shigjetë tejpërtej
në zemërn e vizatuar
pastaj prej karshi
shikoja rrëketë e gjakut
që merrnin siluetën
e trupit të çdegëzuar
prej rrebesheve të kohës.

LUHATEN RROKAQIEJT

-Gonxhe Bojaxhiut-

Dua të di për Shkupin
për lagjen buzë Vardarit
për varret që si kalbin
eshtrat në tokën pjellore.
Mbi varre luhaten rrokaqiejt
gjaku vlon nëpër damarë
Vardari s' ka aq ujë t'i freskojë
unë natën vonë lutem
pranë eshtrave-
në kishën e rrënuar
nga rrokaqiejt në tokën time.
Ata flasin një gjuhë
prej saj do të gonxhojë
lulja e popullit tim.

MERIMANGA E ZEZË

Ëndërrat s’pajtohen me mendimet
sytë shikojnë ardhmëri laramane
qentë endacakë lehin në mikrofon
-MERIMANGA E ZEZË-
infekton plagët e shekullit
fëmijët vdesin duke ardhë në jetë
korbat e zinjë u këndojnë
nënave mbi kokë.
Hënës ia zënë dritën me errësirë
-SHEKULLORE-.

DREDHITË E KOHËS

Mbi shkrepat e malit
retë rrokullisen
kurse shqiponjat kacafyten
me DREDHITË E KOHËS
dhe UJKUN E URITUR
për gjakun ILIR,duke thënë:
-“KËTU E GJETA REHATINË TIME”
edhe pse ti dhe mali gjëmoni
s’ hapen frengjitë
e shtëpive të gurta.

GJËMIM VARRESH

Liria e shkëputur është
-GOSTI E HELMUAR-
i tha plaku i moçëm
mbretit egërsirë.
Në heshtje shikojmë
imazhe arkivolesh
nga trurët-
e kafkave të copëtuara
vlon gjaku në damarë
e varret gjëmojnë për
-LIRINË E SHKËPUTUR-.

KRONGJI GJAKU

Nëpër yjet e natës
shpërndahen plagë
me krongji gjaku
plot dyzet vjet
arnoj lëkurën
nga plumbat
e lavires plakë
që magjeps
kokat e virgjëra
të botës laramane.

VESHKLA PËR TRANSPLANTIM

Tryeza plot
mendime varresh.
Plaku me një dhëmb
përtyp një vesh
të ndarë pesë copësh
trurin që mban në dorë
herë e dredhë herë e mbëledh
nëpër flokë të një dame
me thonjë si kanxha
e ngjyrë gjarpëri
referuesi kërkon qetësi
nga pirunat që kapin
-VESHKLA PËR TRANSPLANTIM-
dhuratë gjeneralëve
të -LUFTËS MAKABRE-!

KTHJELLIM NË ËNDËRR

Nën urdhër të huaj jam
ditën me diell e natën me hënë
bëj luftë me vetveten
duke u dehur me aromën
e parfumit në shishe
frigohem mos përmbyset
pushteti që i jam besnik
KTHJELLOHEM NË ËNDËRR
me gabimet e jetës
fajësoj hënën pse i bëhet
nuse diellit,yjet më përqeshin
unë ua kthej shpinën.

VRASJE BILBILASH

Shuplaka e plasaritur
plotë alfabete kohe
më të kaluarën time
faktet e drejtësië
mbështjellë me lëkurë
    GJARPËRI
vriten bilbilat
pse këndojnë në iso
për trungun e lisit plak.

AMANETI

Me ato pak pare qefini
bleni tesha për fëmijët.

Ato copa druri
ruani për dimrin e egër.

Ushqimin-drekë
për të vdekurit
le ta hanë fëmijët këtë vit.

Më e lehtë do të jetë toka
sikur me ato harxhime
të shohi dritën dorëshkrimi
-ZOTI ËSHTË KUDO-
08 .05. 96

(Në sallë të operacionit)

Shkup

IV. XHINDËT E NATËS

RETUSH VARRI

Ulurima e erës
tmerronte thellimin e natës
artisti shikonte njerëzit
me armët e asnjë kohe
mbi kokë urdhëronin
më mirë e më shpejt
të bënte RETUSH VARRIN
ai me dorën e vet e trurin e huaj
bëj thonte RETUSH o të marrë
dikush nën rrebesh flitte për qelbësirën
e një grusht i fortë pas qafe
zhduku:retushin,varrin e qelbësirën
toka u mbush me leshra laviresh.

XHINDËT E NATËS

Në shtëpinë përdhese
nën çati gjysëm të zbuluar
kalova natën pa gjumë
në shtratin dërrasë ahu
i gëdhendur me sëpatë.

Shiu që s' ndalej dëgjonte
ndodhitë nëpër xhamin e thyer
nga xhindët e natës.

DRITË FRENGJISHË

Labirinthet e kalasë
nën këmbë shkrinin
shkallët e akullta
dhe mbyllnin rrugicat
para sysh valvitej
flamuri i vdekjes.

Nëpër frengji
vinin ca rreze drite
ku shikoja popullin
si rrëzonte hënën
prej një flamurit.

J E T A

Më veshi këpucë të vjetra
setër me arrna e kësulë të re.

Më ndali në udhëkryqin
ku vet isha varur te druri i thatë.

Nën atë pak hije rrënkonin varret
prej krokamës së pacivilizuar.

Kësula e re më groponte
trurin e jetës së re.

JETA ËSHTË POEZI

Lulja ka aromën
që i jep bukuri
jeta ka poezinë
që i jep melodinë

Ai që këput lulen
vërtetë bën krim
zhduk aromën
meriton dënim.

Ai që të merr lirinë
s’ ka rehati
s’ kupton jetën
as lulen,as poezinë.

G J U R M Ë T

Siç pritte shpata
e SKENDERBEUT
ashtu shkruante
me pendën Barleti.

Linte gjurmë
brusha e Onufrit
nëpër libra e
KULLA TË GURIT.

Thyen shpatën e
e Turqisë i
vënduan themelet
-SHQIPËRISË-.

LULEBOZHURI

Ku lulon lulebozhuri
aty ka një varr
e në atë varr
një trim shqiptar.

Gjaku lëshon rrënjë
rrënja lulebozhurin
lulebozhuri gjallon
    -TRIMIN-.

O F S H A M A

Promilat e alkoolit
me gjakun kacafyten
truri shqetsohej për
memori të shëndoshë.

Aroma paraqet ndjenjat
e ëndërrës në gjumin e rëndë.

Lukthi bën grevë
me ushqimin e helmuar
duke e përcjellë nëpër
zorrë të cilat ngushtohen
kurse truri lëshon
-OFSHAMË-.

BOTA MORRI ZJARRIN

- Dr. R . W -

Si mos të mendoj
për Ty e mira e dheut!
Edhe sot flokët kundërmojnë
dhe sjellin freskinë e
DETIT ADRIATIK.
Atë natë kur deti u mbars
në Plazhin e Madh.
Hëna vonë lëshonte rreze
e bota morri zjarrin.
Të nesërmen-kërkuat
qumsht lehone
për Kosovën time.
Shkurt i thatë botës:
“E kam obligim profesioni”.

V . RINGJALLET VETËDIJA

GURRA POETIKE

Aty ka shkelur teknika
e dhijës dyjare
për fijen e barit
plotë qumësht ilaç.

Aty ka bërë roje llulla
bashkë me plumbat rebel
e mustaqet vesh më vesh.

Aty ka shkruajtur poeti
vargje thikë në zemër
në gurrat e kristalta
histori e pambaruar.

Aty rrjedh gjak
pa shenjë varri
-GURRA POETIKE-
aromë e lirisë së gozhduar.

KATAROSHËT

Fëmija i mbështjellë në pelena
kërkonte lëmoshë te Ura e Gurit
nëna kishte shkuar
të fillojë një jetë të re.

Ca fëmijë me nënat për dore
kërkonin lëmoshë te
 -PALLATI I DREJTËSISË-
trembeshin prej atyre
me dhëmbët katarosh që
i kërcisnin si ujqë të uritur
në dekadën e fundit!

Ca prindër si për inat
mbillnin e ujitnin lule
në fytyrën e deputetit të popullit,
te parku i Pallatit të Drejtësisë.

08 . 06 . 94
Shkup

N A T A

Këtë natë pa Hënë
mjegullat mbi kulm
ma prishin gjumin
Astma më shtyp në
-KRAHËROR-.

Shikoj si përmbyset qielli
një SOFËR shtrohej
pa asnjë kafshore buke.

Prindi i mbyt
të shtatë fëmijët rreth
-SOFRËS-
ç' natë na qenka kjo?!

RINGJALLET VETËDIJA

Në themelet e
Orakullit të Dodonës
gjarpërinjtë këndojnë
këngë varresh.

Ca shpirtëra
hekin valle
ca të tjerë
i gjuajnë me gurë.

Krimbi bën
punën e vet
Ringjallet vetëdija.

G A B I M I
-Hasan Kaleshit-

Isha te varrezat
varrin Tënd se gjeta
e din Ti vet babi.

Zënkat me nënën vazhdojnë
por tash me mua babi.

Vinë plot njerëz
për T y folin keq
pak ruhen nga unë.
Më përbuzin pse kam
gjakun Tënd babi!

Thonë të ngjaj Ty
e unë krenohem
besom babi.

Ndoshta do të bëjë gabime
por gabime martese Jo.

SHITEN SI LAVIRE

Kriminelë e tradhtarë
lindin si njerëz
shiten si lavire
cofin si qentë…

NATA E MADHE

Natën e Madhe
zgjohen të vdekurit
për të matur-
mëkatet në këtë botë.

Ca qelben
vjellin gjak
gjarpërinjtë
ua kafshojnë gjuhën.

Piskamat ua dëgjojnë
të afërmit në gjumë.

Qentë lehin
gjersa gjelat këndojnë
vjellsirën e qelbosur
prap e fusin në bark.

SHOKËT E PËRQESHIN

Guri po të dyndet
ai më nuk rritet
por rrokulliset.

Shokët e përqeshin
gjarpërinjtë gëzohen
drunjtë i lirojnë rrugë
uji thot:
-le të shkojë ky i marrë.

ESHTRAT BËRTASIN

Eshtrat bërtasin
-kush jeni ju që,
na tronditni ne
dhe kohën ILIRE?!

Kazmat gërmonin dheun
tokmakët thenin gurë
KAFKAT vërtetonin fjalët
gazetat u përmbushën
të nesërmen s' doli
    -RILINDJA-.

Bota u bind
zogjtë dhanë kushtrim
të ndalet vaji.

Një dorë e këputur
ndante bukë pa ndal.

V I T I 2001

Viti i hajes së dosjeve
të shumë gjeneratave
të mbushura plot
mllef,skamje,vuajtje…

Nga ato që përditë
bënin mësim e hartim
pasdite mbushnin dosjet
e pjellës së vet.

Mbrohen si nepërka
me gojën plot vrer
përpiqen si bolla
e vrar në mes.

HËNA E KA NDIE

Hëna e ka ndie plakun
kur ka lënë një amanet
telat çiftelisë mos i dryshken
dhe pa nevojë mos harxhohet fishek.

Bari të mos bëhej kuq
lulet të mbajnë ngjyrën e vet
plak e plakë mbetshin
kush s' e respekton këtë amanet.

MATANË DARDANELEVE

Matanë Dardaneleve
të bëhet trupi shkrumb
për ëndërrat fëmijërore
në zemrën e shkatërruar
ngushëllon vetveten me fëmijën
që kur lindi qau shqip
herë pas here një shpresë
me dridhje trupi si purtekë
për vizitë-SHTËPISË PA NJERËZ-
lotë për ditarin plot pesëshe
për rrugën te Kodra e Kishës
që u trembëm nga troku i kalit azgan.
Të dijë fëmija për vendlindjen e nënës
të qajmë atje nga larg-
MATANË DARDANELEVE!

L A J M E T

Dikur në radio
lajmet e paraditës
shanin germën
- A -
Në televizion
lajmet e pasditës
shanin germën
-SH-
Të parat s’ më habitnin
të dytat më nervozonin
vërtetë ishin të marrë.

VI. ARRNIMI ESHTRAVE

LOJA HISTORI

Dikur luanim
lojën pasuri
tash e quaj
-LOJA HISTORI-

Merrte më shumë mall
ai me dorën e gjatë
dilte në sinor të huaj
dhe fillonte shamatë.

Si harta gjeografike
bëhej ajo copë tokë
shumë kishte të drejtë
ai me miq e shokë.

TRUPI I SHKALLMUAR

Nata e zezë ferr
thyen eshtrat në shtrat
në trupin e shkallmuar
prej plagësh njerëzore.
Bebëza prej kohësh qanë
për gjumin e ikur
prej trupit të shkallmuar.
Yjet krejt të kuq e lakuriq
dhe rrezja e hënës nuse
me gjak arrnojnë eshtrat
e populliut në trupin e thyer.

MUSHKËRITË ZGJEROJNË PARZMËN

Tash kur dritat
janë ndezur në mol
një vllad valësh deti
nga larg diç më fol.

Zemra shpejton ritmin
këmbët dridhen purtekë,
ëndërra shekullore
u bë realitet.

Mushkëritë zgjerojnë parzmën
prej ajrit të pastër-eter,
rrëndohen edhe shkëmbinjtë
s' kishte rrugë trjetër.

VII . QENTË KUR BËHEN BUÇA

BOTA NË EKSTAZË

Qielli leckoset
kur qentë bëhen buça
dielli errësohet
kur hëna vajton si nuse
kur nën rrezet e saj
çnderohet lehona
në stilin shtazarak
duke cakërruar gotat
për mishin në hell
të botës në ekstazë.

BOTA LARAMANE

Liria në ëndërr
është kometë e shpërbërë
si histori para kohe
e luftëtarëve të trilluar
në botën laramane
të patriotëve nxitës
me dhembje në zemër
e ritëm normal.

SHPIRTI I TRUPIT KUFOMË

Si bari i përzhitur
i ishin thinjur flokët
rapsodit në shtratin e
 -GJERGJ ELEZ ALISË-
krejt jeta i përplasej
në telat e çiftelisë
gishtat e shtanguar
shikonin me mallëngjim
pesë minutat e jetës
që priste e përcillte
njerëz të gjallë
dhe njerëz të vdekur
me atë shikim të mjegulluar
të shpirtit mbi trupin kufomë.

MURI MAKABËR

S’ bashku me freskat
-ONUFRI-
e vëndoi këtë çang
që tash s’ më lejon
të bëj një sy gjumë!

Më përhiret një mur
me gjembor vdekjeje.

Onufri i vëndon krahët
dhe më thot:
-MOS U TREMB-
duke sharë këtë mur
-MAKABËR-.

S’ ËSHTË MUNDUR

Ecim vertikalisht
për t’ i zgjidhur
problemet në horizontale.

S’ është e mundur
të thyhet-
-GURI SINOR-!

L U T J E T

Atë natë vonë
hëna ishte e plotë
  BETOVENIN
e kisha shok.

Tingujt-
vinin nga larg
si vullkan i zjarrtë.

Lutej Betoveni
tingujt të kenë liri.

NAPRANËT E KOHËS

Thellë në greminë
kërkon gjuhën e këputur
gruaja shtatzënë
për fetusin që ia gërvish
mitrën me kërthizë
nënës me sy të gërmuar
prej Napranëve të Kohës
asaj i vlon qumshti
në damarë me gjakun
duke e ruajtur me fanatizëm
gishtin e unazës nusërore.

F A T I…

Një natë-
isha në Afrikë
një turmë njerëzish
pash duke ikë.

Më tutje-
ishte një i vrar
thonin:”I ZI QENKA”
s’ duhet qarë!

TRURI VRAGOSUR

Zemra-
dhe sytë e mi
qajnë,pa ndal
në vetmi.

Një rreze dritë
më bën shoqëri
më trimëron-
për jetë dhe dashuri.

I lënduar nga koha
trupi plot plagë
angazhuar janë do mjekë
për të thella vërragë.

VJETËRSIA

Në odën e Kullës së Vjetër
dy gozhda janë në mur
të moçme janë ato-
sa vet nën ta ai mur.

Në njërën është var KANDILI
në tjetrën është JATAGANI
s’ është trembur gjyshi nga terri
as kur ka fryer MURLANI…

SOFRA E VJETËR

Qan sofra e drurit
që prej kohësh është varë
rreth e rrotull dhomës
ka filluar të mbijë bar.

MERIMANGA-
e ka mbuluar me rrjetë
pluhur në çdo kënd
në shtëpi s' ka jetë.

Mallkon gozhdën
që e mban fort në mur
s' shtrohet e mbushur plot ushqim
në të s' ulet:grua,fëmijë a burrë.

QANË QETË
-SH.S-

Të poshtëruar e kërrusur
e shohim rrugëve pa rrugë
krijuesin dhe artistin
e dikush mendon
se poeti ka vdekur
Ai i këndon qetë
-KËNGË POEZISË-
duke QARË FATIN e
-KOMBIT-…

KULLA E ËNDËRRAVE

Somnabulët udhëtojnë
rrugës së ëndërrës
që s’ u mundëson
ngrohtësia diellore.

Rrugë u bëhet
rrezja e hënës
që u shtrohet gjer te
-KULLA E ËNDËRRAVE-
ku në mesin e perlave
ndodhet Liza e Bukur.

Nënat frigohen
mjekët ua zënë rrugët
Liza hidhërohet,duke thënë:
-SA TË PA SHPIRT Ë JANË-.

KULLA E GURIT

-A.M-

E ndërtuar dikur
por saktësisht s’ dihet
dimë se e kanë rrahur dallgët
pasi edhe sot e bëjnë.
Për çudi s’ u frigohej
hudhej,bënte luftë dhe fitonte.
Një ditë morri rrugë nëpër ato dallgë
e pulëbardha i tha:
-mos atje valët janë më të tërbuara
s’ trembem tha nga valët jam nga
-KULLA E GURIT-
E ndiqte pulëbardha,por dikur u humb
vërtetë asaj i erdhi shumë keq.
E një ditë ajo diku prap i foli:
të shikoja nëpër estrada dhe duartrokitja.
Ne sot prap i shikojmë nëpër frengji
valë e tërbuara,që rrahin muret e
-KULLËS SË GURIT-.

PËRMBAJTJA

1.Grisja e natës……..
I.VDEKJEN E KEMI HËNGËR……
2.Piedestal i kalbur…….....
3.Shpirti pa fjalë……...
4.Merimanga…….....
5.Bulzimi……...
6.Histori e grisur…….
7.Rrobet e vdekjes……..
8.Prishja e kuptimit të ëndërrës…….
9.Pushkatimi im……
10.Truri i kulluar……..
11.Vdekjen e kemi hëngër……
12.Shqiponja e ngujuar…….
13.Shtimi i qyqes……..
14.Krateri i lirisë……..
15.Varri poetit……..
16.Mjegullat shekullore……
17.Roja e qiellit……
18.Jeta në gotë uji…….
19.Pisllëk truri……..
20.Dhembje të thella……
21.Ushtarët e gurëzuar…….

22.Dallgëzim mendimesh…….
23.Shpirti gjak gjarpëri……
II. COPËTIM I NATËS……
24.Karbonizim i lules……...
25.Këngë zjarri
26.Truri i fëmijëve të kërrusur……..
27.Të vërteta të pa qena……
28.Ide të purpurta…….
29.Copëtimi i natës……
30.Rob i gjumit…….
31.Merimanga në Paris……
32.Gjeni……..
33.Rrënjët e zisë……
34.Vdekja hidhërohet……
35.Dita e tmerrit……
36.Rreze plumbash……
37.Fati……
38.Damar jete……
39.Aureola e lavdisë…….
40.Shi pikëllimi……..
41.Kini kujdes…….
42.Fortësia……..
43.Qentë e Ballkanit……
III.DALJE NGA FERRI…….
44.Ringjallja……..
45.Molla provokuese……
46.Dalje nga ferri…….
47.Ku-Ku-ja……..
48.Ëndërra sterile…….

49.Fiks-vaksina…….
50.Hëna……..
51.Silueta……
52.Luhaten rrokaqiejt……
53.Merimanga e zezë…….
54.Dredhitë e kohës……..
55.Gjëmim varresh……..
56.Krongji gjaku…….
57.Veshkla për transplatim……..
58.Kthjellim në ëndërr……
59.Vrasje bilbilash……..
60. Amaneti…….
IV.XHINDËT E NATËS……
61.Retush varri……
62.Xhindët e natës…….
63.Dritë frngjishë……
64.Jeta…….
65.Jeta është poezi…….
66.Gjurmët…….
67.Lulebozhuri……..
68.Ofshama……
69.Bota morri zjarrin…….
V.RINGJALLET VETËDIJA……..
70.Gurra poetike……
71.Kataroshët……
72.Nata……..
73.Ringjallet vetëdija……
74.Gabimi……..
75.Shiten si lavire……..

76.Nata e madhe…….
77.Shokët e përqeshin……
78.Eshtrat bërtasin……
79.Viti 2001……
80.Hëna e ka ndie…….
81.Matanë Dardaneleve…….
82.Lajmet…….
VI. ARRNIMI ESHTRAVE……..
83.Loja histori……
84.Trupi i shkallmuar……
85.Mushkëritë zgjerojnë parzmën…….
VII.QENTË KUR BËHEN BUÇA…..,
86.Bota në ekstazë…….
87.Bota laramane…….
88.Shpirti i trupit kufomë……
89.Muri makabër…….
90.S' është e mundur…….
91.Lutjet…….
92.Napranët e kohës…….
93.Fati……
94.Trupi vragosur…….
95.Vjetërsia……
96.Sofra e vjetër……..
97.Qanë qetë……
98.Kulla e ëndërrave……
99.Kulla e gurit……